



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr. 296 / Prot.

3

Vlorë më, 24.12.2024

VENDIM
Nr. 72, datë 23.12.2024

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË
PËRJASHTIM DHE REDUKTIM NGA TARIFA

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM nr. 39, datë 23. 01. 2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21. 12. 2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, të ndryshuar", VKM nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 269, datë 29. 03. 2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr. 3022/1 prot, datë 23.12.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 23.12.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë dhënie të bursës për 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) studentë, për vitin akademik 2023-2024, me efekt financiar 7,830,000 lekë.
2. Të miratojë përjashtimin nga tarifa për 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) studentë, për vitin akademik 2023-2024, me efekt financiar 2,443,200 lekë.
3. Të miratojë reduktimin nga tarifa për 30 (tridhjetë) studentë, për vitin akademik 2023-2024, me efekt financiar 942,000 lekë.
4. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
5. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zv. Rektorit Akademik dhe Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

